

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS, KORÇË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Korçë, me objekt “Mbi realizimin e te ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacionit doganor për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2012” dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 156, datë 20.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, u janë dërguar përkatësisht me shkresat nr. 573/16, datë 20.12.2013, znj. Erjona Rafti, Kryetare e Degës së Doganës, Korçë dhe me nr. 573/17, datë 20.12.2013, znj. Elisa Spiropali, Drejtore e Përgjithshme e DPD, Tiranë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga Dega Doganore Korçë të merren masa në të ardhmen që, në rastet e diferencave në peshë, praktikat doganore me këtë problematikë të rikanalizohen për kontroll të plotë fizik, pasi kanë rezultuar pa kontroll fizik dhe për shkeljet e konstatuara të dokumentohen, të analizohen dhe të evidentohen rast pas rasti, në zbatim të kërkesave të parashikuara nga ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Në vazhdimësi**

2. Nga Dega Doganore Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të merren të gjitha masat për zbatimin e dispozitave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor në vlerë **254,892,575 lekë**. (Trajtuar në R P Auditimit në faqet 36-39).

**Vazhdimisht**

3. Nga Dega Doganore Korçë në bashkëpunim me DPD të merren masa të plota ligjore, organizative dhe teknike për kontrollin dhe mbikëqyrjen e rreptë të aktivitetit të subjekteve të autorizuar për përdorimin e regjimeve ekonomike, kryesisht për regjimin e përpunimit aktiv dhe lejimit të përkohshëm pasi nga auditimi kanë rezultuar mospërputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore. (Trajtuar në RPAuditimit në faqet 34-36).

**Vazhdimisht**

4. Nga Dega Doganore Korçë, në bashkëpunim me DPD të merren masa të plota ligjore, organizative dhe teknike për përllogaritjen dhe arkëtimin e rentës minerare për subjektet eksportuese pavarësisht përllogaritjeve automatike të sistemit informatik. (Trajtuar në RP Auditimit në faqen 35).

**Në vazhdimësi**

### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Dega Doganore Korçë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **18,330,641 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit si më poshtë:

1. Vlera prej **856,923 lekë**, nga subjektet sipas pasqyrave nr. 3 dhe 5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për detyrime doganore të pa llogaritura ose të llogaritura më pak, për vlerësimin doganor gjatë procedurave të zhdoganimit, për vitin 2011 në shumën 349,117 lekë dhe vitin 2012 në shumën 507,806 lekë. (Trajtuar në faqet 12 - 32 të R P Auditimit).

**Brenda datës 31/03/2014**

2. Vlera prej **8,511,573 lekë** për vitin 2011, nga subjektet sipas pasqyrave nr. 1 dhe 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për detyrime doganore të pa llogaritura për peshën e pa cilësuar dhe të pajustificuar, që variojnë deri dhe mbi 5 % të peshës së deklaruar, për shpenzime transporti të

pa llogaritura, ose llogaritur më pak, për origjinën preferenciale. (Trajtuar në faqet 10-28 të R P Auditimit).

**Brenda datës 31/03/2014**

3. Vlera prej **400,000 lekë** për vitin 2012, nga subjektet sipas pasqyrave nr. 4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për detyrime doganore të pa llogaritura për peshën e pa cilësuar dhe të pajustificuar, që variojnë mbi 5 % të peshës së deklaruar. (Trajtuar në faqet 29-32 të R P Auditimit).

**Brenda datës 31/03/2014**

4. Vlera prej **400,000 lekë** për subjektin [REDAKTUAR] për detyrime doganore të pa llogaritura të vitit 2011 dhe 2012, për mos mbajtje regjistri dhe akt rakordim, për importet dhe eksportet për ambalazh plastik në artikullin bidonë dhe kova plastike, në vlerë 200,000 lekë dhe subjekti [REDAKTUAR] për importe mbi limitin e miratuar në autorizim, në vlerë 200,000 lekë. (Trajtuar në faqet 29-32 të R P Auditimit).

**Brenda datës 31/03/2014**

5. Vlera prej **7,558,598 lekë** për subjektin [REDAKTUAR] për shkeljet e konstatuara në RPA, për detyrime doganore të pa llogaritura për vitin 2011 dhe 2012, për rentën minerare. (Trajtuar në faqet 34-35 të R P Auditimit).

**Brenda datës 31/03/2014**

6. Vlera prej **553,547 lekë** për subjektin [REDAKTUAR] për shkeljet e konstatuara, për detyrime doganore të pa llogaritura për vitin 2011 dhe 2012, për mos mbylljen e regjimit të lejimit të përkohshëm në afatin e caktuar në autorizim. (Trajtuar në faqen 35 të R P Auditimit).

**Brenda datës 31/03/2014**

7. Vlera prej **50,000 lekë** për subjektin [REDAKTUAR] për shkeljet e konstatuara në regjimin e lejimit të përkohshëm, për detyrimet doganore të pa llogaritura për vitin 2011 dhe 2012, për deklarim kode të ndryshëm nga ai i autorizuar. (Trajtuar në faqen 35 të R P Auditimit).

**Brenda datës 31/03/2014**

### **C. MASA DISIPLINORE**

**C.1** Në bazë të VKM nr. 205, datë 13.4.1999 të ndryshuar me VKM nr. 686, datë 02/11/2005, pika 16.1, gerrat “a”, “ç” dhe “ë”, **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** ti propozojë Komitetit Disiplinor marrjen e masave disiplinore si më poshtë:

**“Ulje një shkallë në kategori dhe transferim nga pozicioni i punës 1 vit”, pika 18.1.4 gërma “d” për :**

1. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor i Kontrollit Dokumentar dhe Vlerësimit pas zhdoganimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në cilësinë e ish-doganier regjimesh, në D D Korçë për:

- Të meta dhe mangësi, në Regjimin e Përpunimit Aktiv, pa llogaritur dhe mbajtur rentën minerare për subjektin [REDAKTUAR] në kundërshtim me nenin 40, të Ligjit nr. 10280, datë 20.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” neni 117 dhe të meta e mangësi në regjimin e lejimit të përkohshëm, për subjektin [REDAKTUAR] në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet, nenet 256.2, 256/4 dhe 273 të tij, megjithëse nuk ka mbyllur regjimin e lejimit të përkohshëm, për importe të kryera dhe pa i eksportuar sipas autorizimit të dhënë, të cilat duhet të kthehen në import 4 me regjim 4053 000, nuk

është llogaritur detyrimi doganor dhe vendosur penalitet. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35-36 të RPAuditimit).

**“Humbjen e të drejtës së shpërblimeve për 1 vit” pika 18.1.4 germa “c” për :**

1. ■■■■■ me detyrë doganier në Degën e Doganës Kapshticë, në cilësinë e ish- doganier regjimesh në DD Korçë për:

- Të meta dhe mangësi për dy praktika për Import 5, në kundërshtim me nenin 256/2 dhe 275/1 të “Kodit Doganor”, për diferencë peshe midis librezës së mjetit dhe fletë peshës për peshën bosh të mjetit, pa llogaritur detyrimin doganor dhe pa vendosur penalitet. (Trajtuar më hollësisht në faqen 36 të R P Auditimit).

C.2 Në bazë të VKM, nr. 205, datë 13.4.1999 të ndryshuar me vendimin nr .686, datë 02/11/2005, pika 16.1, gerrat “a”, “ç” dhe “ë”, **Dega e Doganës Korçë** ti propozojë Komitetit Disiplinor marrjen e masave disiplinore si më poshtë:

**“Ulje një shkallë në kategori dhe transferim nga pozicioni i punës, 6/muaj”, pika 18.1.4 germa “ç” për :**

1. ■■■■■ me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, për:

- Në vitin 2011 dhe 2012, për të meta dhe mangësi në 21 praktika, për të cilat janë bërë ndërhyrje për rritje të vlerës, ose më pak se çmimi i referencës, për diferencë peshe midis librezës së mjetit dhe fletë peshës që variojnë mbi 5% të peshës së deklaruar, përlllogaritjet e vlerës me shpenzime transporti, origjinën preferenciale, si dhe disa parregullsi në deklaratat doganore pa llogaritur detyrimet doganore, pa vendosur penalitet, në kundërshtim me nenet 34-38, 256/2/4, 261/1//2 dhe 275/1 të “Kodit Doganor”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 10-33 të R P Auditimit).

2. ■■■■■ me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, për:

- Në vitin 2011 dhe 2012, për të meta dhe mangësi, për diferencë në peshë midis librezës së mjetit dhe fletë peshës, peshë e pa cilësuar dhe justifikuar, në 15 praktika që variojnë mbi 5% të peshës së deklaruar si dhe disa parregullsi në deklaratat doganore pa llogaritur detyrimet doganore, pa vendosur penalitet, në kundërshtim me nenet 256/2/4, 261/1//2 dhe 275/1 të “Kodit Doganor”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 10 -32 të R P Auditimit).

3. ■■■■■ me detyrë doganier klasifikim/vlerësim dhe kontroll fizik, për:

- Në vitin 2011 dhe 2012, për të meta dhe mangësi, në kundërshtim me udhëzimin e DPD nr. 1, datë 14.01.2011 “Mbi Procedurën e Përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në sistemin asycudaworld”, për 10 praktika që kanë kaluar në kanal të verdhë, të cilat janë nënshkruar, pa kaluar në kanal të kuq, si dhe për diferencë në peshë midis librezës së mjetit dhe fletë peshës të pa cilësuar dhe të pa justifikuar, në kundërshtim me nenet 256/2/4, 261/1/2 dhe 275/1 “Kodit Doganor”, pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësia ndaj subjekteve. (Trajtuar më hollësisht në faqet 10-20 të RPAuditimit).

**“Vërejtje me paralajmërim”, pika 18.1.4, germa “a” për :**

1. ■■■■■ me detyrë Përgjegjës në Zyrën e Operacioneve Doganore, për shkeljet e konstatuara në deklaratat doganore si më poshtë:

- deklaratën R 1008 datë 16.04.2012 - subjekti ■■■■■ me efekt negativ në të ardhurat doganore prej 10,032 lekë.

- deklaratën R 1009 datë 16.04.2012 - subjekti ■■■ me efekt negativ në të ardhurat doganore prej 241,659 lekë.
- deklaratën R 1020 datë 17.04.2012 - subjekti ■■■ me efekt negativ në të ardhurat doganore prej 50,000 lekë.
- deklaratën R 1009 datë 16.04.2012 - subjekti ■■■ me efekt negativ në të ardhurat doganore prej 241,659 lekë.
- deklaratën R 1317 datë 12.05.2012 - subjekti ■■■ me efekt negativ në të ardhurat doganore prej 50,000 lekë.
- deklaratën R 2307 datë 10.08.2012 - subjekti ■■■ me efekt negativ në të ardhurat doganore prej 50,000 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqet 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Per punonjesit:

1. ■■■ me detyrë ish-Kryetar i Degës Doganës Korçë, propozohet masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, sipas kontratës individuale të punës, por meqenëse me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 16896/6, datë 27.11.2013, është larguar nga puna, masa disiplinore quhet e ezaruar.
2. ■■■ me detyrë ish përgjegjëse e zyrës operacionale.
3. ■■■ me detyrë ish doganier Regjimesh dhe
4. ■■■ me detyrë ish doganier/pranim/peshore pikë kontrolli,

Nuk rekomandohet masë disiplinore, pasi nuk ndodhen aktualisht në marrëdhënie pune në sistemin doganor.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Din Zenelaj p/grupi, Hodo Hasani, Marvin Karalli, Rustem Tare dhe Pullumb Beqiraj, më tej u shqyrtua nga K/audituesi z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.

**Mbi zbatimin e rekomandimeve:**

Me shkresën nr. 181, datë 14.01.2014, Dega Doganore Korçë, ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme, nga ku rezulton se janë zbatuar të gjitha masat organizative të propozuara. Masat për shperblim dëmi, në vlerën 18,330,641 lekë, (7 raste), janë në proces zbatimi në vazhdimësi. Nga këto masa disiplinore të propozuara, janë zbatuar nga Dega e Doganës Korçë dy prej tyre. Nuk ka përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për dy masa disiplinore.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**